



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 07/140
Datë: 26.04.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 95, paragrafi 2. të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 05/L-068 dhe me Ligjin Nr. 05/L-092, të nenit 3, paragrafi 1, të Udhëzimit Administrativ Nr. 06/2018 për Zbatimin e Proceduarve Qendrore të Prokurimit Publik, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive të ndryshuar dhe të plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 26 prill 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Ndryshohet dhe plotësohet lista e artikujve për përdorim të përbashkët që janë objekt i procedurës qendrore të prokurimit publik, e aprovuar sipas pikës 1. të Vendimit të Qeverisë Nr. 06/27 të datës 30 prill 2020, me listën e bashkëngjitur në Shtojcën 1. të këtij Vendimi.
2. Pikat tjera të Vendimit të Qeverisë Nr. 06/27 të datës 30 prill 2020, mbesin të pandryshuara.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë

Shtojca I

Artikujt dhe Shërbimet që janë pjesë e prokurimeve të përbashkëta

Nr.	Përshkrimi	Lloji i Kontratës	Kohëzgjatja
1	Furnizimi me letër për kopje	Kornizë	2 Vite
2	Furnizimi me material zyrtar	Kornizë	2 Vite
3	Furnizimi me goma për automjete	Kornizë	2 Vite
4	Furnizimi me vetura të udhëtarëve	Kornizë	1 Vit
5	Furnizimi me artikuj ushqimor	Kornizë	1 Vit
6	Furnizimi me mobile	Kornizë	1 Vit
7	Furnizimi me pajisje të teknologjisë informative	Marrëveshje kornizë	1 Vit
8	Furnizimi me pemë dhe perime	Marrëveshje kornizë	1 Vit
9	Veturat me qira për trupat inspektuese	Kontratë afatgjate	5 Vite
10	Shërbime fotokopjimi, skanimi dhe printimi- me qira	Kontratë afatgjate	3 Vite
11	Furnizimi me karburante	Kornizë	1 Vit
12	Furnizimi me mazut	Kornizë	2 Vite
13	Furnizimi me ujë të pijes	Kornizë	3 Vite